


I gjithe parku perreth zones se ish-Kinostudios eshte konceptuar si nje lende publike, e hapur per te gjithe qytetaret dhe perdoruesit, jo vetem ne sherbim te plotesimit te momenteve te tyre rekreative dhe kulturore, por edhe si nje moment ekspozimi dhe vendtakimi per vete qytetaret me artistet dhe perdoruesit me te 'vecante' te saj.

02. Aktivizimi i Parkut

Aktivizimi me perreth me pavijone kulturore, dhe hapesira per aktivitete ne sherbim te publikut dhe qendres kulturore




pavijone 'hangari i artit'

Ne kete prizem, jane menduar per disa pavijone ne park te cilat mund te ofrojne ambjente te pershtatshme per keto takime mes publikut dhe artit.




reference per pavjonin 'hangari i artit'

- hangari i artit



reference per pavjonin e sherbimit




pozicionimi ne plan i pavjont te sherbimit


Ne afersi te hyrjes kryesore per ne Ministrine e Kultures dhe buze rruges kryesore vendoset 'Hangari I Artit'. Ky pavijon eshte menduar si njje kontenier I cili realizohet nepermjet nje skeleti metalik te jashtem, dhe ofron hapesire boshe ne brendesi. Qellimi kryesor eshte eleminimi I kolonave apo elemnteve konstruktiv qe e kufizojne hapesiren per te lene sa me te lire ambientin brenda tij. Ky boshlek e ben kete pavijon lethesisht te pershtatshem per cfare dolloj aktiviteti rekreativ, punetorie edukative, apo kulturor ne kuader te perdorimit te parkut.

- Pike Sherbimi

Ne afersi te tij gjendet edhe nje pike sherbimi, e cila duket te jetet e domosdoshme per te ofruar mundesine e sherbimeve te ushqimit dhe pijeve si ne perditshmeri ashtu edhe ne rastet e vecanta.



reference per pavjonin e shtepiza e bimeve



pozicionimi ne plan i shtepizes se bimeve

- Shtepiza e Bimeve

Ne pikën kulmore ne parkut, aty ku infrastruktura e bute e gjelberimit takon kryqezimin e dy rrugëve kryesore, eshte vendosur 'shtepiza e bimeve', qe do te jete nje ambjent krejtesisht transparent, per te kultivuar bime dhe mbarevajtur sistemimin e jashtem te te gjithe parkut. Duke qene pika me e ekspozuar e parkut, ky ambjent me nje shkalle modeste do te jete nje pike relaksimi per kopshtarine dhe specialitetet e gjelberuara te parkut te Artit.

- Instalacioni 'Shoke dhe Engjej'

Nje nga momentet me te spikatura te parkut do te jete dhe instalacioni artistik 'Shoke dhe Engjej' nga artisti Italian Alfred Pirri. Ai realizon nje instalacion I cili merr zanafilë nga nje cellule transparent me permaza 3m me 5 me, e cila risjell ne mendje kujtimin e qelise se




instalacioni 'Shoke dhe Engjej'

aktivistit komunist Antonio Gramchi. Qelia kryesore eshte e shtruar ne siperfaqe solide dhe ruan aty nje trendafil ne kujtim te tij. I gjithe instalacioni ruan permasat e qelise kryesore dhe shpaloset ne palate muresh, shumefishime te ketyre permasave qe qendrojne te hapura ne 1, 2 ose 3 faqe te kuadratit te pote. Keto mure vertikale perbehen nga panele



detaj nga instalacioni 'Shoke dhe Engje'



pozicionimi ne plan i instalacionit 'Shoke dhe Engje'

transparente pleksiglasi me ngjyra te ndryshme dhe ne brendesi te tyre perbehen nga pupla si dhe ndricim te mevetshem. Ky artikulim muresh me kënde 90 grade ndaj njeri-tjetrit eshte nje nga momentet me pikante qe qendron I ndricuar gjate gjithe kohes dhe sjell kombinime te ndryshme te thyerjes se drites teksa qendron I lire mbi lendenen e gjelberuar poshte tij.


Instalacioni eshte I vendosur per gjate rruges 'Xhanfize Keko' dhe ka nje shikueshmeri te larte, duke lejuar ndricimin e vecante dhe ngjyrimet e tij te jete te lexueshme edhe ne

distance nga zonat urbane perreth saj.


Instalacioni perbehet nga panelet shumengjyreshe pleksiglasi me pupla te integrhuara si dhe nga struktura/kornizat prej celiku ku vendosen panelet. Panelet kane lartesi prej 3 m dhe gjeresi 1m (e cila eshte variable dhe mund te jetë 1-1.3m ne varesi te paneleve ne dispozicion ne treg per te mos i prere dhe patur teprica.) Struktura perbehet nga profile celiku 50x50x3mm dhe fiksohet ne toke nepermjet kembezash celiku me lartesi te modifikueshme per tu pershtatur ndryshimeve te terrenit. Kembezat fiksohen ne themele blloku betoni C20/25 me dim 300x300x300mm te zhytura 15cm nga niveli i tokes.

- Pavijoni 'Canopy'

Ne afersi te godines fundore e cila do te shnderrrohet ne 'Qendren Kulturore' te Parkut te Artit, vendoset nje pavijon me strehe i cili sherben si nje vendpushim apo nje vend



pavijonit canopy me strehe



pozicionimi ne plan i pavijonit canopy me strehe

mireseardhjeje per perdoruesit ne rastet kur ka nje event ne sallat e brendshme te qendres kulturore, ose si nje ambjent prites ne vetvete me per raste prezantimesh apo takimesh ne kopshtin e hapur. Ky pavjon kompozohet nga nje structure e lehte metalike e cila vishet me nje cohe te lehte dhe te lekundshme si ne formen e nje strehe. Ai eshte menduar te sherbeje per takime te ndryshme duke ofruar menyra te ndryshme sistemimi, si duke ndenjur ashtu edhe duke lejuar organizimin e karrigeve te levizshme per gjate brinjes me te gjate te tij, ne rastet e prezantimeve me podium qendror. Ky pavjon mund te sherbeje edhe si nje ' foyer' ose parahyrje per qendren kulturore.

Art Park